



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. 1032 prot

Durrës, më 31.08.2020

VENDIM

Nr. 11, datë 31.08.2020

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë", të vendimit të këshillit të ministrave nr.658, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit dhe Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, vendimit nr.54, datë 04.05.2020 të Senatit Akademik, urdhërin e përbashkët të RASH dhe QSHA nr.02., datë 02.07.2020, Rektorati në mbledhjen e datës 31.08.2020,

VENDOSI:

1. Të konstitujë Rektoratin pas rezultatit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, datë 30.07.2020.
2. Të marrë masat për rikthimin në auditorë me datë 1 Shtator, realizimi i përsëritjeve të leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike për studentët e vitit të parë dhe të dytë të ciklit të studimeve bachelor dhe për studentët e vitit të parë të ciklit të studimeve master.
3. Të ngarkojë Dekanët e fakulteteve, Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme të marrin masa për zbatimin me korrektësi të rregullave të distancimit social, për parandalimin e përhapjes së COVID-19.
4. Në javët që do të realizohet përsëritja e leksioneve dhe seminareve, pjesëmarrja do të jetë fakultative, si rrjedhojë studentët nuk mund të penalizohen për mungesa.
5. Të ngarkojë Dekanët e fakulteteve, Sekretaritetë mësimore, Drejtorinë e Shërbimeve Akademike të marrin masa për orientimin e studentëve të cilët regjistrohen për herë të parë, në vitin e parë, cikli i parë i studimeve.
6. Të ngarkojë Dekanët e fakulteteve, Sekretaritetë mësimore, për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimeve duke respektuar datat dhe afatet e përcaktuara në urdhërin e përbashkët nr.2, datë 02.07.2020 të QSHA dhe RASH.

7. Të ngarkojë Administratorin për marrjen e masave në krijimin e faciliteteve për studentët e vitit të parë, të cilët duhet të paguajnë tarifën e regjistrimit në Kampusin Universitar.
8. Të ngrejë grupin e punës me zv.dekanët për anën mësimore me qëllim hartimin e një rregulloreje për mënyrën e zhvillimit dhe monitorimit të procesit mësimor për vitin akademik 2020-2021, si alternativë mësimi në distancë.
9. Të ngarkojë Dekanët e fakulteteve për marrjen e masave në përmbylljen e procedurave dhe dokumentacionit për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë Doktoraturë.
10. Realizimi i Konferencës vjetore me Universitetin e Prizrenit data 5-6 nëntor 2020.
11. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
- Administratori i UAMD
 - Zv. Rektorët
 - Dekanët e fakulteteve
 - Drejtoria e Shërbimeve Akademike
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë
 - Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme

REKTOR
Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

